



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.28/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesuese, Kymete Kicaj dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelin e Gogić Stevan, për shkak të mos përfshirjes në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET apeli A.nr.28/2019, i Gogić Stevan, paraqitur kundër KQZ për shkak të mos përfshirjes në listën e votuesve jashtë Kosovës, për arsye se parashtruesit të apelit i mungon interesi juridik.

A r s y e t i m

Komisioni Qendror i Zgjedhje me datë: 19.09.2019 ka miratuar listën përfundimtare për votuesit jashtë Kosovës.

Me datë 20 shtator 2019 parashtruesi i apelit Gogić Stevan, ka parashtruar ankesë kundër vendimit të KQZ të datës: 19.09.2019 kur është miratuar lista përfundimtare e votuesve, me pretendimin se i njëjti edhe pse kishte aplikuar me datë: 09.09.2019 për të hyrë në listë të votuesve jashtë Kosovës, me rastin e publikimit të listës nuk e ka gjetur emrin e tij në listë. I njëjti thekson se në të gjitha zgjedhjet e mëparshme të përgjithshme ka pasur drejtë për të votuar, ndërsa në këtë rast është refuzuar paligjshëm.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht apelin, gjeti se:

Parashtruesit të Apelit i mungon interesi juridik

Nga shkresat e lëndës rezultojnë se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë: 19.09.2019 ka miratuar listën përfundimtare të votuesve. Me datë: 20.09.2019 Gogić Stevan, ka parashtruar në PZAP ankesë ndaj vendimit për miratim të listës përfundimtare të votuesve. PZAP ankesën e ankuesit e trajton si apel meqenëse ndaj vendimeve të KQZ palët e interesuar mund të parashtrorin Apel.

Me rastin e shqyrtimit të Apelit PZAP iu ka drejtuar KQZ për të dhënë përgjigje në raport me apelin e parashtruesit dhe pretendimeve që dalin nga i njëjti.

KQZ me anë të përgjigjes në apel dërguar në PZAP ka konfirmuar se parashtruesi i apelit gjendet në listën e votuesve meqenëse i njëjti i plotëson kushtet për tu përfshirë në listë.

PZAP duke vlerësuar apelin e personit në fjalë vlerëson se në rastin konkret të njëjtit i mungon interesi juridik për parashtrimin e apelit meqenëse i njëjti është i përfshirë në listën e votuesve.

Andaj PZAP-i, konstaton se apeli i parashtruar është pa interes juridik pasi Gogić Stevan, gjendet në listën votuese

Prandaj PZAP-i, mbi këtë baze dhe nga arsyet e sipërsënuar dhe në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.28/2019 më datën 22.09.2019.

**Kryesuese e Panelit
Fejzullah Rexhepi**



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.